



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:274320

Datë: 19.06.2023

Numri i dokumentit: 04408403

PS.nr. 53/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti Special, sipas kryetares së trupit gjykues Violeta Namani Hajra, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Laurant Avdyli, në çështjen penale kundër të pandehurit L.B, për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës nën shenjë PPS.nr.70/21 të datës 20.12.2022, duke vendosur sipas kërkesës për hedhje të aktakuzës, së mbrojtësit të pandehurit L.B av. Gani Zabeli, konform nenit 248 par 1 pika 1.5 të KPPRK-së, jashtë seance, me datë **30.05.2023** merre këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** kërkesa për hudhjen e aktakuzës e mbrojtësit të pandehurit L.B av. Gani Zabeli ashtu që:
- II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Speciale të Kosovës, PPS.nr.70/21 të datës 20.12.2022 dhe,
- III. PUSHOHET procedura penale** ndaj të pandehurit **L.B**, nga i ati, dhe e ëma, e gjinisë, i lindur me datë, në, me vendbanim në, në rrugën “.....” nr....., kati i-të, i martuar, babai i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të mesme ekonomike, me nr. personal:, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,
- IV.** Pasi që në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme, të cilat e mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.
- V. Palët e dëmtuara:** A.B, me vendbanim në rruga “.....”, pn, dhe Komuna e, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.
- VI.** Shpenzimet e kësaj procedure penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

VII. ANULOHET Urdhëri për ndalim afatgjatë të aseteve i lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, PPPS.nr.38/2021, e datë 28.09.2022, me të cilën janë sekuestruar përkohësisht paluajtshmëritë si më poshtë, dhe është urdhëruar ndalimi i tjetërsimit të këtyre paluajtshmërive apo objekteve ndërtimore, si dhe çdo ndryshim në librat kadastral, dhe atë për ngastrat që janë objekti i kësaj çështje penale si në vijim :

1. **Një lokal afarist në katin**, me sipërfaqe, me nr....., në bazë të tatimit në pronë sipërfaqe prej, janë të regjistruara në emër të investitorit A.B, , e regjistruar në bazë të parcelës katastrale me nr..... me sipërfaqe prej ZK –
2. **Një banesë në katin e**, me sipërfaqe metra katror, sipas regjistrimit të tatimit në pronë dhe para kontratës e lidhur me datë, me investitorin A.B, e regjistruar në bazë të parcelës katastrale me nr..... me sipërfaqe prej ZK –, kjo banesë është regjistruar në emër të B.B (vëllai i A.B),.
3. **Një (1) banesë në katin e II-të, nr. 2**, me sipërfaqe 101.08 metra katror, sipas regjistrimit të tatimit në pronë dhe para kontratës e lidhur me datë 20.10.2019, me investitorin A.B, e regjistruar në bazë të parcelës katastrale me nr..... me sipërfaqe prej 0.28.17 ha (2817m2) ZK –....., kjo banesë është regjistruar në emër të I.M.
4. **Një (1) banesë në katin e III-të, nr.5**, me sipërfaqe 101.08 metra katror, sipas regjistrimit të tatimit në pronë, e regjistruar në bazë të parcelës katastrale me nr..... me sipërfaqe prej 0.28.17 ha (2817m2) ZK – kjo banesë është regjistruar në emër të pandehurit L.B.
5. **Një (1) lokal afarist në katin përdhësë nr.1**, me sipërfaqe 84 metra katror, e regjistruar në bazë të parcelës katastrale me nr..... me sipërfaqe prej 0.28.17 ha (2817m2) ZK –, sipas tatimit në pronë, është në emër të E.B, 3 (tri) locale me nga 28 metra katror (gjithsejtë 84 metra katror).
6. **Një (1) banesë në katin e I-rë, nr.3**, me sipërfaqe 101.72 metra katror, e regjistruar në bazë të parcelës katastrale me nr..... me sipërfaqe prej 0.28.17 ha (2817m2) ZK – Kaçanik, sipas tatimit në pronë, kjo banesë është regjistruar në emër të N.B.
7. **Një (1) banesë në katin e II-të, nr.6**, me sipërfaqe 101.72 metra katror, e regjistruar në bazë të parcelës katastrale me nr..... me sipërfaqe prej 0.28.17 ha (2817m2) ZK –, sipas tatimit në pronë, kjo banesë është e regjistruar në emër të F.B.
8. **Një (1) banesë në katin e III-të, nr.9**, me sipërfaqe 101.72 metra katror, e regjistruar në bazë të parcelës katastrale me nr..... me sipërfaqe prej 0.28.17 ha (2817m2) ZK –, sipas tatimit në pronë kjo banesë është e regjistruar në emër të H.B.

Dhe, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi, titullarve të këtyre paluajtshmërive - pronarëve iu lejohet disponimi me të gjitha autorizimet që burojnë nga të drejtat pronësore për këto ngastra kadastrale.

A r s y e t i m

Me datë 20.12.2022, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngrit aktakuzë nën shenjën PPS.nr.70/21 të datës 20.12.2022, kundër të pandehurit L.B për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Duke vepruar sipas aktakuzës konform nenit 240 të KPPRK-së, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 18.04.2023 pas leximit të aktakuzës të pandehurit L.B iu është dhënë mundësia të deklarohet lidhur me veprën penale të cilën ngarkohet. I pandehuri L.B është deklaruar i pa fajshëm për veprën penale për të cilën i vihet në barrë dhe kryetarja e trupit gjykues, e ka udhëzuar në të drejtat e tij të parapara me nenin 243 dhe 244 të KPPRK-së ashtu që të pandehurit dhe mbrojtësi i tij është udhëzuar se kanë të drejtë në afat prej 30 ditëve nga dita e shqyrtimit fillestar të paraqesin kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave.

Mbrojtësit e të pandehurit L.B av. Gani Zabeli, në afatin ligjor, me datën 11.05.2023 ka parashtruar kërkesë për hedhje të aktakuzës. Konform nenit 245 të KPPRK-së, gjykata i ka dhënë mundësinë Prokurorisë Speciale, që të përgjigjet në lidhje me kërkesat e ushtruar nga mbrojtësi i të pandehurit L.B av. Gani Zabeli, si më lartë. Me datë 17.05.2023, Gjukata ka pranuar përgjigjen nga Prokuroria Speciale, lidhur me kërkesat si më lartë.

Gjukata vlerëson se qëllimi i kundërshtimit të provave dhe kërkesës për hudhje të aktakuzës, të parashikuar nga KPP, është të eliminohen lëndët që vërtetë nuk kanë meritë dhe të mbrohen të pandehurit nga ekspozimi i pajustificuar dhe potencialisht i gjatë në shqyrtimin gjyqësor. Në kundërshtim me KPPK-në, sipas strukturës ligjore të KPP-së, gjykata nuk ka më të drejtë të vlerësojë plotësisht aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave duke vepruar sipas detyrës zyrtare. Kundërshtimet kundër provave dhe/ose kërkesat për hedhjen e aktakuzës duhet të paraqiten nga mbrojtja në bazë të neneve 243 dhe 244 të KPP-së. Prokurori ka mundësinë t'u përgjigjet këtyre kundërshtimeve dhe/ose kërkesave, siç parashikohet në nenin 245. Argumentet e ngritura nga të dyja palët shqyrtohen nga Kryetarja e trupit gjykues, me qëllim që të bëjë vlerësimet përkatëse.

Kërkesat për hedhje të aktakuzës.

Sa i përket kërkesës për të hedhur Aktakuzën, KPP parasheh kritere të qarta që duhet të merren parasysh, si rezultat nga neni 244 (1) i KPP-së.

I pandehuri mund të paraqet kërkesë për hedhjen e aktakuzës, bazuar në këto arsye:

-Vepra për të cilën akuzohen nuk përbën vepër penale;

-Ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;

-Ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra penale është e përfshirë në falje, ose ekzistojnë rrethana tjera të cilat e pengojnë ndjekjen;

-Nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë;

- Aktakuza është ngritur brenda afatit të paraparë në nenin 234 të këtij Kodi;

-Aktakuza është në kundërshtim me ligjin;

Dyshimi i bazuar mirë është definuar në nenin 19 (1.12) të KPP-së dhe nënkupton “posedimi i provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që një veprë penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri”. Standardi i “vëzhguesit objektiv” kërkon prova që do të bindnin shumicën e njerëzve se vepra penale është kryer nga i pandehuri.

Pretendimet e palëve

Mbrojtësi i të pandehurit L.B av. Gani Zabeli, në afatin ligjor, me datë 11.05.2023 ka paraqitur kërkesën për hudhje të aktakuzës Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës - departamenti për korrupsion publik dhe krime me datë 08.07. 2021 nxjerrë Aktvendim për fillimin e hetimeve për Zyrtarë komunal në drejtim të dyshimit se 2 zyrtaret në kallëzimin penal të policisë secili veç e veç kishin kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 122 par. 1 lidhur me par.2 të KPRK-së, ndërsa L.B dhe A.B Berisha dyshohen se kanë kryer veprën penale Mashtrim nga neni 335 par.5 lidhur me par. 1 të KPRK-se. Sipas mbrojtjes obligim për zbatim të aktgjykimit kishte Komuna e Kaçanikut e rrjedhimisht nënkupton se moszbatimin e tij mund ta shkaktoi vetëm ajo, përkatësisht zyrtaret përgjegjës, prandaj mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në vetvete paraqet veprë penale e parapare me nenin 102 të Kodit Penal nr. 01/1-82, i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, veprë penal kjo e paraparë edhe me nenin 394 të Kodit të ri penal nr. 06/L.074. Sipas mbrojtjes është e pa kuptimtë që Komuna e Kaçanikut, në këtë rast në Akuzë të trajtohet si pale e dëmtar, në vend se e njëjta të jetë përgjegjëse për veprën penale dhe dëmin e shkaktuar si ndaj familjes Berisha po ashtu edhe ndaj investitorit. Mbrojtja pretendon se në veprimet e të pandehurit nuk ekzistojnë elementet e figurës së veprës penale të Mashtrimit, për të cilën akuzohet, për faktin se i njëjti nuk ka qene në dijeni të ekzistimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme dhe atë për faktin se i njëjti nuk ishte palë në këtë procedure civile, edhe përkundër faktit se në cilësinë e palës paditëse në këtë kontest ishin familjaret e tij përkatësisht baba dhe axhallarët, kontest ky i cili zanafillën e vete e ka qysh në vitin 1986. Tutje ka pretenduar se gjate marrjes në pyetje në polici dhe Prokurori, i njëjti në vazhdimësi ka deklaruar se nuk ka qene në dijeni për Aktgjykimi e Gjykatës Supreme, e as të Aktgjykimeve të Gjykatave të rangut më të ulët lidhur me këto prona, kjo është mëse e besueshme duke marre parasysh se i njëjti është laik në fushën juridike ka një përgatitjen profesionale -në fushën e hotelierisë. I pandehuri duke qene bashkëshortë, baba i dy fëmijëve por edhe udhëheqës i biznesi hotelier në të cilin ishte ortak me të dëmtuarin A.B tërë kohën dhe fokusin e tij e kishte në këto çështje ndërsa sa i përket problemeve të familjes së gjer ai për këto nuk kishte as kohe as interes madje çështja e pronës kontestuese në familjen e tyre konsiderohej obligim për të cilën angazhohej paraardhësit e tyre (baba dhe axhallarët). Nga ky

fakt rrjedh edhe konkludimi se i njëjti nuk ka interes, aftësi personale, profesionale e as intelektuale ta mashtrojë të dëmtuarin A.B, me paraqitje të rremë të fakteve, apo duke i fshehur faktet për përfitim të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, pasi që këta të dy njiheshin në mes vete, qysh prej kohësh ishin shoqe, ishin ortak në biznesin e tyre - lokalin hotelier "Tropikali", mbi të gjitha i pandehuri asnjëherë nuk kishte pretenduar që ishte pronar i kësaj paluajtshmërie. Prova me e fuqishme e pretenduar nga Prokurorit me anë të cilës pretendohet se dëshmon faktin se i pandehuri e ka qenë në dijeninë rreth ekzistimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.251/2009 datë 16.01.2012, është një pagese të taksave gjyqësore kundër Aktvendimit të Gjykatës se Apelit AC.nr.3003/12, të cilën i pandehuri L.B me datë 10.05.2013 e kishte paguar. Vet i pandehuri e ka pohuar se një pagese të tillë e ka realizuar dhe atë me kërkesën e të autorizuarit të familjes- avokatit, por në asnjë mënyrë kjo nuk mund të vërtetojë faktin qenësor se ishte në dijeni se çfarë përmbante ankesa e hartuar nga avokati i angazhuar nga familjaret, veprimi i të pandehurit ishte thjeshtë një veprim administrativ dhe asgjë me shume. Mbrojtja pretendon se konstatimi i Prokurorisë se me vet faktin se i pandehuri paska bere pagesën e një urdhër pagese ndaj një Aktvendimi të Gjykatës se Apelit, që ka pas lidhshmëri me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, e ka ditur se ekziston një Aktgjykim i Gjykatës Supreme dhe se e paska ditur se çfarë qenka vendosur në të, konsiderojnë se një konkludim si i tille është plotësisht i pabazuar, në logjikën e një personi laik, i paragjykuar, dhe me këtë prokurori i rastit tenton të mbulojë dështimin e tij për të prezantuar prani gjykatës prova konkrete dhe të artikulueshme ashtu siç parasheh me Kodin Penal. I pandehuri disa here radhazi gjatë marrjes në pyetje në polici dhe Prokurori lidhur me këtë Aktgjykim të Gjykatës Supreme është deklaruar "se nuk kame pasur dijeni për ekzistimin e këtij Aktgjykimi", Sipas mbrojtjes në përpjekjet e tij për ta arsyetuar aktakuzën, prokurori deklaroi se "i pandehuri gjate dhënies së deklaratave në polici me datë 16.01.2020 dhe në Prokurori speciale me datë 18.08.2022, e pranon se fillimisht ka bërë marrëveshje verbale me A.Bn, pastaj është pajisur me fletë poseduese nga Komuna e Kaçanikut dhe se bashku me prindin, axhën kane shkuar tek noteri ku kanë bërë marrëveshje të shkruar, sipas se cilës familja merr banesa dhe lokal, pa e njoftuar fare investitorin të dëmtuarin rreth procedurave gjyqësore". Nga ky tentim i prokurorit për ta gjetur me çdo kusht fajtor të pandehurin L.B, doemos duhet të interpretojmë në mënyrën e sakte dhe të drejtë përgjigjet e dhëna nga i pandehuri pasi që janë po këto përgjigje të cilat pa dyshime e vërtetojnë faktin se si mbrojturi i tij nuk ishte në dijeni për ekzistimin e një aktgjykimit të tille aq më shume për përmbajtjen e tij. Fakti se i pandehuri ka deklaruar pranë prokurorisë dhe policisë se fillimisht ka bërë marrëveshje verbale me A.Bn, nuk i shtonë qëndrueshmëri aktakuzës së ngritur, pasi që arritja e një marrëveshje verbale është proces normal, në çdo raport kontraktual marrëveshja verbale i paraprinë veprimeve tjera formale. Pra i mbrojturi i tij me këtë e ka thënë në kontestin e dëgjimit të bisedave të zhvilluar mes investitorit- tani të dëmtuarit dhe babait dhe axhallarëve dhe se nuk qëndron fakti se i pandehur ka qenë prezent te noter kur edhe janë nënshkruar kontrata mes palëve kontraktuese ashtu siç pretendon prokuroria, se nuk ka qenë prezent këtë e vërteton edhe i dëmtuari në deklaratën e tijë dhënë në prokurori me datë 01.10.2022, kur prokurori dëshmitarit i parashtron pyetjen se a i kujtohet, a ka qenë i pranishëm tek noteri duke aluduar në të pandehurin L.B, i dëmtuari ka thënë se nuk e di, e nuk i kujtohet. Me një konstatim të tille prokurori me vetëdije apo pa vetëdije e amnistion fajtorin e vetëm, për faktin se ishte Komuna e Kaçaniku ajo e cila me mos veprim kishte konsumuar veprën penale

"Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore" parapare me nenin 102 si dhe vepra penale "Keqpërdormi i pozitës apo autoritetit zyrtar" te parapare me nenin 122 par 1 lidhur me par 218 KPRK-ës, për faktin se ishte Komuna e Kaçanikut ajo e cila edhe pas 5 vite të plotfuqishmërisë se këtij vendimi nuk e kishte zbatuar të njëjtin, ishte vetëm komuna e Kaçanikut e cila sipas ligjit dhe pushtetit kishte mundësin dhe detyrimin për ekzekutim, prandaj rrjedhimisht po të kishte vepra "e dëmtuara" sipas përgjegjësisë të cilën e ka nuk do të kishte pasur mundësi që i pandehuri apo familjaret e tyre të vihen në lajthitje duke u furnizuar me çertifikate të pronësisë në emër të tyre, rrjedhimisht edhe i dëmtuari – investitori. Prandaj për fajin e mos funksionimit të organeve shtetërore nuk mund që të thirren në përgjegjësisë qytetaret e rëndomte. Mirëpo nga deklaratat e të akuzuarit Lulim Berisha dhënë në Polici me datë 16.01.2020 si dhe në atë të dhënë në Prokurori me datë 12.08.2022, me pyetjet e parashtruara nga ana c Prokurorit është deklaruar se "personalisht nuk kam njohuri për ekzistimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, se nuk din se kush e ka pranuar të njëjtin, dhe se nuk jam i njoftuar nga familjaret e mije - baba im se ka pranuar këtë Aktgjykim, në kontestin e këtyre përgjigjeve, i ka shpjeguar deklaratat të dhëna me gjerësisht ne faqen 6, 7 dhe 8 se kush ka arritur marrëveshje me investitorin, cila ka qene sipërfaqja e dhënë për ndërtim, sa metra banese dhe lokal ka marre babi dhe axha i tij, dhe se nga prindi si trashëgimtare i tij ka marre një banese në të cilën aktualisht jeton dhe një lokal afarist i cili ende nuk është përfunduar". Mirëpo është e pashmangshme që edhe i akuzuari të mos ketë qene interesuar me investitorin - tani të dëmtuarin për mënyrën dhe përqindjen, të cilat do te caktohen me marrëveshje për ndërtimin e përbashkët, në mes familjareve te tij dhe atij, por jo për ta shtyrë apo për ta mbajtur në lajthim të dëmtuarin, për arsye se këta duke pasur biznes të përbashkët, të mëhershëm kane pas kontakte të rregullta ditore, e mirëbesim të ndërsjellët, pa e ditur asnjeri e as tjetri për ekzistimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me te cilin për moment ishte ndërruar pronari mbi ketë pasuri, mirëpo jo edhe juridikisht, pasi që Aktgjykimi si i tille nuk është zbatuar nga ana e drejtorisë se kadastrit dhe pronës në Komunën e Kaçanikut, ashtu siç është detyruar ky organ në dispozitivin e tij. Pra prona kishte ngelur edhe më tutje në emër të,, dhe, si pasojë e kësaj të njëjtit në ketë organ kishin nxjerre fletët poseduese - certifikatën e pronës në emër të tyre. Investitori se bashku me pronaret e tokave ishim pajisur me terë dokumentacionin e nevojshëm dhe të domosdoshëm për ndërtimin e objektit shume banesore, certifikatën e pronësisë, Kontrata dhe marrëveshje me shkrim të përpiluara pranë noterit Hebib V. Livorceka me seli ne Kaçanik, Kontratat mbi shitblerjen e patundshmërisë me kompensim L.R.P. nr. Ren 1333/2015 me nr. të referencën 1192/2015 dhe kontratën L.R.P. nr.Ren1331/2015, me nr. të referencës 1193/2015 me të cilat behet bartja e pronësisë në emër të investitorit tani te dëmtuarit A.B nga Kaçaniku, pastaj pëlqim për i komunës 06 numër 350-29619/2015. ndërtimore e datë 18.11.2015, vrojtimi lejes 06 nr. 351- 29619/2015, ku është shënuar se kjo leje ndërtimi i jepet, pasi që investitori është pajisur me lejen mjedisore komunale, pëlqim për kryerjen në infrastrukture teknike, pëlqim për sanitari dhe projekt, pëlqim për preventiv për mbrojtje nga zjarri si dhe vendimi për ndërrimin e destinacionit të tokës nga ajo lugësore në ndërtimore. Gjate investimit inspektori i ndërtimit e kishte mbikëqyruar ndërtimin e këtij objekti në të gjitha fazat deri në momentin kur ju kane ndërprerë punimet në vitin 2017. Prandaj, prokurori me një aktakuze të mirëfillte të bazuar me prova konkrete me një rrjedhë të logjikshme, të akuzuarin e vetëm do te duhej te kishte Komunën e Kaçanikut-rrjedhimisht përgjegjësit në ketë komune, jo vetëm se me mos veprim të tyre nuk kanë zbatuar një vendim

gjyqësor i cili vite me pare ishte mare, por me mos veprimin e tyre kishin vene në lajthitje si familjen Berisha të cilët në regjistrin kadastral evidentohen si pronarë por edhe investitorin i cili para fillimit të investimit kishte kërkuar informata të besueshme- të sakta pranë organit administrativ për gjendjen e kësaj parcele dhe ishte informuar se e njëjta është në pronësi të familjes Berisha. Mbi bazën e këtyre informatave të marr nga organi administrativ palë kontraktuese investitori - A.B dhe pronaret R.B....., E.B....., H.B..... dhe K.B..... kishin arritur marrëveshjen për investim pranë noterit, pastaj investitori kishte aplikuar për kushte ndërtimore, për leje ndërtimore dhe një mori leje të tjera, dhe ishte pikërisht Komuna e Kaçanikut ajo cila i kishte aprovuar duke i mundësuar investitorit ndërtimin e objekti banesor- afarist, ndërtim ky i cili kishte kërkuar vite kohë për tu realizuar dhe gjatë kësaj kohe as edhe një here të vetme nuk ishte njoftuar as familja e as investitori nga Komuna se diçka nuk është në rregull, prandaj me këto veprime përkatësisht mos veprime të Komunës së Kaçanikut nuk është dëmtuar vetëm familja por është dëmtuar edhe vete investitor. Pas ndërprerjes se punimeve në ndërtimin e objektit ana e Komunës së Kaçanikut dhe kthimi i pronës se paluajtshme në emër të lidhjes se luftëtareve të L.N.Q Kaçanik. Investitor, i dëmtuari A.B paraqet në Gjykatën Themelore në Ferizaj, dega Kaçanik padi ndaj Komunës së Kaçanikut për çështjen kontestuese, njohja e pronësisë në bazë të ndërtimit në pronën kontestuese. Për të njëjtën çështje, për të njëjtën prone gjashte vite pas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Gjykata Themelore ne Ferizaj dega në Kaçanik me Aktgjykimin C.nr. 74/17 e miraton si të bazuar kërkesën e paditësit – të dëmtuarit A.B nga Kaçaniku, duke ja njohur të drejtën në pronësi në parcelat kadastrale 01121-2 në vendin e quajtur " Oborr" në sipërfaqe prej 1278 m2 ku edhe është ndërtuar objekti banesor. Nga ky fakte mbrojtja është plotësisht e bindur se kjo është çështje juridiko - civile, se nuk kemi të bëjmë me çështje penale - e as përgjegjësi penale të akuzuarin L.B. Nga vete deklarata e investitorit - tani i dëmtuari i cili me datë 01.10.2022 është marrë në pyetje në Prokurorinë Speciale, pranë Prokurorit të rastit, i cili përveç tjerash në njëren prej pyetjeve të Prokurorit ka deklaruar se : "e ndjen veten pale e dëmtuar, i mashtruar si nga Komuna po ashtu edhe nga familja Berisha e kane ditur dhe me kane lejuar qe të hyjë në marrëveshje kontraktuale, unë kërkoj qe ata të ndiqen penalisht". Prandaj mbrojtja pretendon se në veprimet e të akuzuarit nuk ekzistojnë elementet e veprës penale për te cilën akuzohet, nuk ka prova të mjaftueshme për ta mbështetur dyshimin e bazuar mire se i pandehuri L.B ka kryer veprën penale për te cilën akuzohet dhe komfor nenit 248 par. 1, nen par. 1.5 te KPPRK-së, gjykatës i propozoj qe ta hedhë aktakuzën dhe të pushojë procedurën penale ndaj të pandehurit L.B.

Prokurori i Prokurorisë Speciale në përgjigjen ndaj Kërkesës për hedhje të aktakuzës është përgjigjur se pas analizimit të hollësishëm te Kërkesës për Hedhjen e Aktakuzës kanë vërtetuar se realitetin faktik për arsyet e mëposhtme: Së pari, pretendimi i mbrojtjes se "vepra për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale", është qartazi i pabazuar, pasi që elementet e përgjithshme dhe tiparet e posaçme që përbëjnë figurën e veprës penale: Mashtrimi është një vepër penale e dhe orientuar kundër pasurisë (së luajtshme dhe të paluajtshme), duke përfshire edhe të drejtat dhe interesat pasurore. Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale qëndron në paraqitjen e rrejshme të fakteve a duke i fshehur faktet. Me paraqitjen e rrejshme të fakteve nënkuptohet pohimi për vërtet ekziston, (ajo që ekziston tregohet jo saktësisht). Fshehja e fakteve (në këtë rast, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.254/2009, të datë16.01.2012) ekziston kur

kryerësi (në këtë rast L.B), ndonjë person (në këtë rast A.Bn), e mashtron për mosekzistimin e fakteve ekzistuese apo e hesht ekzistimin e tyre, përkatësisht përmbajtjen e tyre, nëse ka ekzistuar detyrimi i tij që ato fakte t'i tregonte. Nga kjo rezulton se mashtrimi mund të kryhet edhe me mosveprim. Paraqitja e rrejshme ose fshehja e fakteve, ndërmerren me qëllim që personi (në këtë rast A.B) të sillet në lajthim ose të mbahet në lajthim dhe në atë mënyrë të shtyhet që të veprojë a të mos veprojë në dëm të pasurisë së tij apo pasurisë së huaj. Me veprimin e tij, kryerësi (L.B) krijon përfytyrim të gabuar te personi (A.B) për ndonjë fakt dhe ashtu e sjell në lajthim atë, ndërsa te mbajtja në lajthim kryerësi shfrytëzon ekzistimin e lajthimit dhe me fshehjen e fakteve, ai lajthimin vetëm e vazhdon ose e forcon. Sjellja dhe mbajtja në lajthim duhet të jetë ndërmarrë me qëllim të realizimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për vete a për tjetrin. Në mes të paraqitjes së rrejshme, përkatësisht fshehjes së fakteve dhe sjelljes në lajthim, përkatësisht mbajtjes në lajthim duhet të ekzistojë lidhja shkakësore, që do të thotë se duhet vërtetuar se kryesi me paraqitjen e rrejshme apo me fshehjen e fakteve e ka sjellë personin tjetër në lajthim ose e ka mbajtur në lajthim, e që në rastin konkret i pandehuri L.B me fshehjen e ekzistimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.254/2009 të datë 16.01.2012, me të cilin kjo pronë është kthyer në gjendjen e mëparshme në emër të P.SH. Lidhja e Luftëtarëve të L.N.Ç - Kaçanik dhe nuk është pronë e familjes, e ka sjellë të dëmtuarin A.B në lajthim për të nënshkruar kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë dhe të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme me kompensim me I.B (babai i të pandehurit) dhe E.B (xhaxhai i të pandehurit). Veprimi të cilin e ndërmerr personi i mashtruar duhet të shkaktojë dëmtimin – zvogëlimin e pasurisë së personit të mashtruar apo pasurisë së dikujt tjetër, që në rastin konkret i është shkaktuar dem material në shkallë të madhe investitorit/të dëmtuarit A.B. Pasoja e kësaj vepre penale qëndron në dëmtimin e pasurisë që kushtëzohet drejtpërsëdrejti nga veprimi i personit të mashtruar, ndërsa indirekt nga veprimi i mashtruesit. Së dyti, nga provat e siguruar dhe të cilat janë të bollshme, pa mëdyshje është vërtetuar dyshimi i bazuar mire se i pandehuri L.B ka kryer veprën penale "Mashtrimi" nga neni 335 par.5 lidhur me par. 1, të Kodit Penal Republikës së Kosovës (Kodi Nr.04/L-082), për të cilën është ngritur kjo Aktakuzë dhe për të cilën i njëjti është penalisht përgjegjës. Rrjedhimisht të gjitha provat në këtë çështje penale janë marrë në mënyrë të ligjshme dhe asnjëra nga këto nuk është në kundërshtim me dispozitat e Kapitullit XVI të KPPRK-së, të njëjtat janë të rëndësishme dhe thelbësisht të mbështetshme dhe si të tilla janë të pranueshme. Prej tyre, dëshmi më të fuqishme paraqesin Urdhërpagesa (e kryer nga ana e të pandehurit L.B - e cila është pohuar edhe në kërkesën për hedhje të aktakuzës) – Dëftesat pagese e taksës gjyqësore për ankesë të datë 10.05.2013 ndaj Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.3003/2012 (me të cilin refuzohet si i pabazuar propozimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.254/2009 të datë 16.01.2012), sipas së cilës vërtetohet Kosovës Rev.nr.254/2009 të datë 16.01.2012, pastaj deklaratat e të pandehurit L.B më datë 16.01.2020, në Policinë e Kosovës, i cili ndër të tjera ka deklaruar se "sa i përket aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, lidhur me pronën ku është ndërtuar objekti banesor se është pronë e Komunes, nuk e di se ku është bazuar, por ajo pronë është prona e jona familjare", (pra shumë qartë nënkuptohet dijenia e tij për Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, por më tepër nuk është pajtuar me të dhe e ka cilësuar si të pabazuar) si dhe më datë 12.08.2022, në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, në të cilat i pandehuri e pranon se fillimisht ka bërë marrëveshje verbale me A.Bn, pastaj është pajisur me fletë poseduese nga Komuna e Kaçanikut dhe së bashku

me prindin I.B, axhën E.B kanë shkuar tek noteri ku kanë bërë marrëveshje të shkruar sipas së cilës familja merr banesa dhe lokale, pa e njoftuar fare investitorin/ të dëmtuarin rreth procedurave gjyqësore, si dhe deklarata e dëshmitarit A.B i cili thekson se ka qenë pikërisht ideja e të pandehurit L.B, për të ndërtuar në atë vend dhe i cili e ka vënë në kontakt me E.B dhe I.B për të lidhur marrëveshje kontraktuale, pa u njoftuar se kjo pronë nuk është e tyre por sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.254/2009 të datë 16.01.2012, është kthyer në emër të P.SH. Lidhja e Luftëtarëve të L.N.Ç-Kaçanik. Nga të gjitha këto që u cekën më lartë, janë të bindur se Kërkesa për Hedhjen e Aktakuzës, e ushtruar nga avokati Gani Zabeli, nga Prishtina - mbrojtës i të akuzuarit L.B (I.B) Berisha, është e pabazuar, andaj i propozojnë gjykatës që kjo kërkesë të hedhet si e pabazuar dhe të vazhdohet në procedurën e mëtejme penale.

Gjetjet e gjykatës,

Kryetarja e trupit gjykues, me rastin e vlerësimit të shkresave të lëndës në raport me pretendimet e mbrojtësit të pandehurit L.B av. Gani Zabeli, gjeti se kërkesa për hedhje të aktakuzës është e bazuar.

Gjykata me vëmendje ka vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të pandehurit L.B av. Gani Zabeli në kërkesën hudhjen e aktakuzës dhe ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe ka arritur në përfundim se duhet të hudhet aktakuza sepse nuk është provuar se i pandehuri L.B ka kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Në dispozitivin e aktakuzës theksohet se:

Ekziston dyshimi i bazuar mirë se, i pandehuri L.B gjatë vitit 2015, duke qenë në dijeni të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.254/2009 të datë 16.01.2012, me të cilën parcela kadastrale nr..... në vendin e quajtur “.....”, me kulturë arë e klasës së dytë, me sipërfaqe prej 0.25.08 ha, dhe pjesa tjetër e ngastrës me kulturë jopjellore në sipërfaqe prej 0.03.09 ha, të gjitha këto në sipërfaqe prej 0.28,17 ha, të evidentuara në fletën poseduese nr..... Zona Kadastrale, janë kthyer në gjendjen e mëparshme në emër të P.SH. Lidhja e Luftëtarëve të L.N.Q - Kaçanik, por me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten, e ka mashtruar investitorin tani të dëmtuarin A.B për të lidhur kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë dhe të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme me kompensim (1 banesë në katin e I-rë, me sipërfaqe prej 101,72 m2 me nr.3; 1 banesë tjetër në katin e dytë, në sipërfaqe prej 101,72 m2, me nr.6; 1 banesë tjetër në katin e III-të, në sipërfaqe prej 101,72 m2, me nr.9; 1 lokal afarist në katin përdhese, me dimension të tërësishëm prej 84 m2, me nr.1) LRP.nr.4333/15 ref.nr.1192/15 i datë 16.10.2015 me E.B (xhaxhai i të pandehurit) dhe kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë dhe të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme me kompensim (1 banesë në katin e I-rë, me sipërfaqe prej 101,08 m2, me nr.1; 1 banesë tjetër në katin e II-të, në sipërfaqe prej 101,08 m2, me nr.5; 1 banesë tjetër në katin e III-të, në sipërfaqe prej 101,08 m2, me nr.10; 1 lokal afarist në katin përdhese, me dimension të tërësishëm prej 80 m2, me nr.3) LRP.nr.4334/15 ref.nr.1193/15 i datë 16.10.2015 me I.B (babai i të pandehurit), me ç`rast i njëjti e ka fshehur Aktgjykimin të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 254/2009 të datë 16.01.2012, për të cilin

aktgjykim i njëjti e ka ditur se parcela kadastrale nr..... në vendin e quajtur “.....”, me kulturë arë e klasës së dytë, me sipërfaqe prej 0.25.08 ha, dhe pjesa tjetër e ngastrës me kulturë jopjellore në sipërfaqe prej 0.03.09 ha, të gjitha këto në sipërfaqe prej 0.28,17 ha, të evidentuara në fletën poseduese nr.1177 Zona Kadastrale Kaçanik, janë kthyer në gjendjen e mëparshme në emër të P.SH. Lidhja e luftëtarëve të L.N.Ç - Kaçanik, e kështu duke i shkaktuar dëm material në shkallë të madhe tani të dëmtuarve, A.B dhe P.SH. Lidhja e Luftëtarëve të L.N.Ç - Kaçanik.

- Me këto veprime kishte për të kryer veprën penale “Mashtrimi” nga neni 335 par.5 lidhur me par.1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi Nr.04/ L082)

Gjykata sjellë në vëmendje se përgjegjësia penale është detyrimi ligjor i çdokujt që shkel një rregullim normativ me karakter penal, për t’iu nënshtruar pasojave ligjore me karakter ndëshkues e parandalues. Nisur nga rëndësia që kanë organet proceduese penale përgjatë të gjithë veprimtarisë që përbën në tërësi procedimin penal, nga intensiteti i madh i kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të subjekteve të nënshtruara dhe nga nevoja për zhvillimin e një procedimi të ndershëm, të rregullt dhe tërësisht në përputhje me ligjin, Kodi Penal ka parashikuar disa kushte kumulative që duhet të përmbushen në çdo procedim penal. Legjislacioni duke konkretizuar parimin e ligjshmërisë të shprehur në nenin 2 të KPRK-së, në pjesën e posaçme të Kodit Penal, ka parashikuar edhe llojet e veprave penale dhe llojet apo masat përkatëse të dënimeve për to. Sipas të drejtës sonë penale, e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është që në veprimet ose mosveprimet e tij të ekzistojnë elementët e një figure të caktuar veprë penale të parashikuar nga ligji penal. Për këtë arsye, bashkë ekzistenca e njëkohshme e elementeve të figurës së veprës penale ka një rëndësi të madhe sepse lidhet domosdoshmerisht me zbatimin e parimit të ligjshmërisë.

Gjykata gjithashtu thekson se barra e të provuarit, se i pandehuri L.B është fajtor për veprën penale i përket prokurorisë si organ i ndjekjes ashtu që prokuroria është e obliguar që të vërtetojë me prova se ekziston përtej dyshimit mirë të bazuar, se i pandehuri L.B ka kryer veprat penale për të cilat ngarkohet. Në aspektin procedural penal, i pandehuri L.B mbulohet nga parimi i prezumimit të pafajësisë si dhe parimi In Dubio Pro Reo (*Mëdyshjet lidhur me provat dhe faktet si dhe zbatimit të ligjit zbatohen në favor të të pandehurit*), po ashtu i pandehuri i lartcekur nuk është i detyruar që ta provoj fajësinë apo pafajësinë e tij.

Që i pandehuri L.B të gjendet fajtor nga gjykata, duhet të provohet se aktakuza e ngritur nga prokuroria është e provuar dhe argumentuar përtej dyshimit të bazuar mirë, e që në rastin konkret prokuroria nuk ka mundë ta bindë gjykatën se me provat e propozuara se i pandehuri i lartcekur ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet sipas aktakuzës. Prezumimi i pa fajësisë dhe barra e të provuarit janë kërkesa imperative dhe të artikuluara në të gjitha të drejtat dhe konventat ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut, e të cilat janë inkorporuar në nenin 3 të KPPRK-së (*Prezumimi i pafajësisë së të pandehurit dhe Parimi In Dubio Pro Reo*) dhe nenin 7 par.1 të KPPRK-së, që nënkupton detyrimin e përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve, këto konstatime gjejnë mbështetje në nenin 11 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 6 par.2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 14 par.2 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

Gjykata vlerëson se për tu gjendur në kushtet e kryerjes së veprës penale Mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së të Kodi Penal i Kosovës NR. 06/L-074, ka përcaktuar në paragrafin 1 *“kushdo që me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër, ose për t’i shkaktuar dëm material personit tjetër, e mashtron apo vazhdon lajthimin e personit tjetër dhe me këtë e nxit një person që të kryej apo të mos kryej një veprim në dëm të pasurisë së tij apo të pasurisë së personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet”,* ndërsa si formë të kualifikuar e ka paraparë nga paragrafi 5 se *“Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton në dobi pasurore të kundërligjshme ose shkakton dëm që tejkalon pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet”,* Mashtrimi është një veprë penale e orientuar kundër pasurisë (së luajtshme dhe të paluajtshme), duke përfshirë edhe të drejtat dhe interesat pasurore. Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale qëndron në paraqitjen e rrejshme të fakteve a duke i fshehur faktet. Me paraqitjen e rrejshme të fakteve nënkuptohet pohimi për ekzistimin e ndonjë fakti që nuk ekziston, përkatësisht paraqitja e fakteve ndryshe nga ajo që vërtet ekziston, (ajo që ekziston tregohet jo saktësisht). Fshehja e fakteve ekziston kur kryerësi, ndonjë person, e mashtron për mosekzistimin e fakteve ekzistuese apo e hesht ekzistimin e tyre, përkatësisht përmbajtjen e tyre, nëse ka ekzistuar detyrimi i tij që ato fakte t’i tregonte. Nga kjo rezulton se mashtrimi mund të kryhet edhe me mosveprim. Ndërkaq, te tregimi i rrejshëm, kryerësi e bind ndonjë person për ekzistimin e ndonjë fakti që nuk ekziston, që do të thotë të fshehja ai pengon personin që t’i mësojë faktet që vërtet ekzistojnë e të cilat janë relevante për pasjen në dispozicion të pasurisë së tij dhe pasurisë së huaj dhe të cilat do ta zbrapsin nga pasojat e dëmshme në raport me këtë pasuri. Mashtrimi, sipas par. 1, ekziston vetëm nëse është shkaktuar me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për vete a për dikë tjetër dhe vepra është konsumuar me ndërmarrjen e veprimit në dëm të pasurisë së tij apo në dëm të pasurisë së tjetrit, pa marrë parasysh nëse një qëllim i tillë është realizuar apo do të mund të realizohej. Në paragrafin 5 është parashikuar forma e cilësuar e kësaj vepre penale, e cila do të ekzistonte kur me rastin e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, rezulton në dobi pasurore të kundërligjshme ose shkakton dëm që tejkalon pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

Në rastin konkret për tu gjetur në kushtet e kryerjes së kësaj vepre penale, është e nevojshme që i pandehur L.B me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër, ose për t’i shkaktuar dëm material personit tjetër, e mashtron apo vazhdon lajthimin e personit tjetër dhe me këtë e nxit një person që të kryej apo të mos kryej një veprim në dëm të pasurisë së tij apo të pasurisë së personit tjetër, në këtë rasti të dëmtuarin A.B, ku sipas gjetjes së gjykatës i dëmtuar A.B ka nënshkruar kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë dhe të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme me kompensim me qytetaret I.B (babai i të pandehurit) dhe E.B (xhaxhai i të pandehurit), dhe nuk ka nënshkruar asgjë formale-ligjore me të pandehurin L.B, andaj gjykata vlerëson se nuk jemi në përmbushje të asnjërit nga këto elemente qenësore të kryerjes së veprës penale të lartcekur, pasi që nga provat e bashkangjitura në aktakuzë gjykata ka konstatuar këtë gjendje faktike:

- Me Aktgjykimin Rev. Nr. 254/2009 të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, të datës 16 Janar 2012, gjykata ka vërtetuar faktin se Gjykata Supreme ka aprovuar revizionin e palës së paditur Komunës së Kaçanikut dhe ka prishur vendimin e shkallës së parë dhe vendimin e shkallës së dytë të cilat vendime për pronën kontestuese si pronar legjitim i ka njohur familjen Berisha, ndërsa parcela kadastrale nr..... në vendin e quajtur “.....”, me kulturë arë e klasës së dytë, me sipërfaqe prej 0.25.08 ha, dhe pjesa tjetër e ngastrës me kulturë jopjellore në sipërfaqe prej 0.03.09 ha, të gjitha këto në sipërfaqe prej 0.28,17 ha, të evidentuara në fletën poseduese nr..... Zona Kadastrale, ju kanë kthyer në gjendjen e mëparshme në emër të P.SH. Lidhja e luftëtarëve të L.N.Ç – Kaçanik.

- Me fletë kthesat e pranimit të Aktgjykimit Rev. Nr. 254/2009 të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, të datës 16 Janar 2012, gjykata ka vërtetuar faktin se këtë aktgjykim e kanë pranuar h.b dhe avokati Muhamet Beqiri, ku në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi-prova tjera që Aktgjykimin e lartcekur e ka pranuar i pandehuri L.B.

- Nga procesverbali për marrjen në pyetje të dëmtuarin A.B në Prokurorinë Speciale me datë 04.10.2022, gjykata ka konstatuar se i njëjti ka shpjeguar në mënyrë kronologjike se si ka ardhur deri tek ndërtimi në këtë parcelë kontestuese duke potencuar se edhe më herët ka pasur një lokal të ndërtuar në këtë parcelë dhe pastaj ka lidhur marrëveshje me familjen për ndërtimin e objekteve banesore dhe i njëjti ka theksuar se ndihet i mashtruar nga komuna e Kaçanikut dhe nga familja

- Nga procesverbali për marrjen në pyetje të pandehurit L.B në Polici me datë 16.01.2020, gjykata ka konstatuar se i njëjti ka shpjeguar se nuk ka pasur dijeni për ndonjë vendim për ndërrimin e pronarit të kësaj toke dhe askush nuk e ka njoftuar për një gjë të tillë. Komuna e Kaçanikut ka paguar vetëm për një pjesë për ujëra të zeza dhe jo më shumë. Gjithashtu kanë nxjerrë të gjitha dokumentet e nevojshme për ndërtim në Komunën e Kaçanikut ku si pronarë figurojnë prindi dhe axha i tij. Po ashtu ka deklaruar se të dëmtuarin A.B e ka vënë në kontakt me familjarët e tij për arritjen e marrëveshjes por i njëjti nuk ka nënshkruar apo marrë pjesë në nënshkrimin e kontratave.

- Nga procesverbali për marrjen në pyetje të pandehurit L.B në Prokurorinë Speciale me datë 12.08.2022, gjykata ka konstatuar se i njëjti ka shpjeguar se nuk ka pasur dijeni për ndonjë vendim nga Gjykata Supreme për ndërrimin e pronarit të kësaj toke dhe askush nuk e ka njoftuar për një gjë të tillë dhe as nuk është në dijeni se dikush nga familjarët e tij e ka pranuar këtë vendim. Në vitin 2000 ose 2001 Komuna e Kaçanikut pronën kontestuese e ka kthyer në emër të Shoqatës Lidhja e Luftëtarëve të Luftës Nacionalçlirimtare në Kaçanik, kurse si familje kanë paditur komunën në Gjykatë, ku gjykata e shkallës së parë ka marrë vendim se prona i takon familjes Berisha dhe këtë vendim e ka vërtetuar edhe gjykata e shkallës së dytë. Tutje ka shpjeguar se si janë marrë vesh me të dëmtuarin A.B për të ndërtuar objekte banesore ku fillimisht është ndërtuar në pjesën kontestuese dhe marrëveshja ka qenë që të ndërtohet edhe në pjesën e pronës ku nuk është kontestuese. Të dëmtuarin A.B e ka vënë në kontakt me familjarët

e tij për arritjen e marrëveshjes por i njëjti nuk ka nënshkruar sepse nuk është pronar pasi që pronar të asaj toke janë babai dhe axha i tij dhe marrëveshja me të dëmtuarin A.B është nënshkruar nga prindi dhe axha i tij. Ka mohuar se dikush nga Komuna i ka kërkuar ryshfet për lëshimin e fletës poseduese apo të lejes së ndërtimit.

- Nga kontrata mbi shitblerjen e patundshmërisë dhe të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së pa luajture me kompensim e lidhur tek noteri Hebib Livoreka me datë 16.10.2015 me nr.ren.4334/2015, në mes të I.B dhe A.B, gjykata ka konstatuar se I.B ja ka dhënë tokën për ndërtim A.Bt dhe nga ky ndërtim I.B do të përfitoj 3 banesa dhe një lokal afarist.

- Nga kontrata mbi shitblerjen e patundshmërisë dhe të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së pa luajture me kompensim e lidhur tek noteri Hebib Livoreka me datë 16.10.2015 me nr.ren.4334/2015, në mes të E.B dhe A.B, gjykata ka konstatuar se I.B ja ka dhënë tokën për ndërtim A.Bt dhe nga ky ndërtim E.B do të përfitoj 3 banesa dhe një lokal afarist.

- Nga marrëveshja për dhënien e tokës për ndërtim, me datë 07.09.2015, në mes të I.B dhe E.B dhe A.B, gjykata ka konstatuar se I.B dhe E.B ja kanë dhënë tokën për ndërtim A.Bt, për ndërtimin e objekteve shumë banesorë, I.B ja ka dhënë tokën për ndërtim A.Bt ngastrën kadastrale nr.01121-7, me sipërfaqe prej 734.86 m², si dhe E.B ja ka dhënë tokën për ndërtim A.Bt ngastrën kadastrale nr.01121-9, me sipërfaqe prej 342 m², ngastrën kadastrale nr.01121-5, me sipërfaqe prej 31 m², ngastrën kadastrale nr.01121-7, me sipërfaqe prej 233 m².

- Nga Propozimi për përsëritjen e procedurës të deponuar pranë Gjykatës Komunale në Kaçanik- për Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, C.nr.41/2002, datë 27.02.2012, nga ana e paditësve R.B, Emi, H.B dhe Keamil Berisha nga Kaçaniku, kundër aktgjykimin të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 254/2009, datë 16.01.2012, ndaj të paditurës Komuna e Kaçanikut, gjykata ka konstatuar faktin se paditësit e lartcekur kanë kërkuar propozimi për përsëritjen e procedurës.

- Me Aktvendimin CA.nr.1539/13, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të datës 05.11.2013, gjykata ka vërtetuar faktin se Gjykata e Apelit ka refuzuar kërkesën për përsëritje të procedurës nga ana e paditësve R.B, E.B, H.B dhe K.B.

- Nga fletë kthesa e Gjykatës Komunale në Kaçanik e pranuar nga Komuna e Kaçanikut me datë 28.02.2012, gjykata ka vërtetuar faktin se Komuna e Kaçanikut ka pranuar Propozimin për përsëritjen e procedurës nga ana e paditësve R.B, E.B, H.B dhe K.B nga Kaçaniku, kundër të paditurës Komuna e Kaçanikut për Gjykatën e Qarkut e datës 27.02.2012.

- Nga fatura e një urdhër pagese me nr. fiskal 600365226 e datës 10.05.2013, gjykata ka konstatuar se i pandehuri L.B paska bere pagesën e urdhërpagesës nga Gjykata Themelore Ferizaj – Dega Kaçanik.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese se në parcelën kadastrale nr..... në vendin e quajtur “.....”, me kulturë arë e klasës së dytë, me sipërfaqe prej 0.25.08 ha, dhe pjesa tjetër e ngastrës me kulturë jopjellore në sipërfaqe prej 0.03.09 ha, të gjitha këto në sipërfaqe prej 0.28,17 ha të evidentuara në fletën poseduese nr..... Zona Kadastrale Kaçanik janë ndërtuar objekte banesore nga i dëmtuari A.B.

Po ashtu nuk ishte kontestuese se në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.254/2009 të datë 16.01.2012, me të cilën parcela kadastrale nr..... në vendin e quajtur “.....”, me kulturë arë e klasës së dytë, me sipërfaqe prej 0.25.08 ha, dhe pjesa tjetër e ngastrës me kulturë jopjellore në sipërfaqe prej 0.03.09 ha, të gjitha këto në sipërfaqe prej 0.28,17 ha, të evidentuara në fletën poseduese nr..... Zona Kadastrale Kaçanik, janë kthyer në gjendjen e mëparshme në emër të P.SH. Lidhja e Luftëtarëve të L.N.Q – Kaçanik

Për gjykatën kontestuese ishte se a ka arritur i pandehuri L.B ta mashtrrojë të dëmtuarin A.B për të ndërtuar objekte banesore në këtë parcelë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nga provat të cilat janë bashkangjitur aktakuzës nuk e mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri L.B ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet me akuzë. Prokuroria pretendon se i pandehuri ka qenë në dijeni të aktgjykimi të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.254/2009 të datë 16.01.2012, me të cilën parcela kadastrale nr.,,,,,,,,,, në vendin e quajtur “,,,,,,,,”, me kulturë arë e klasës së dytë, me sipërfaqe prej 0.25.08 ha, dhe pjesa tjetër e ngastrës me kulturë jopjellore në sipërfaqe prej 0.03.09 ha, të gjitha këto në sipërfaqe prej 0.28,17 ha, të evidentuara në fletën poseduese nr.,,,,,,,,,, Zona Kadastrale Kaçanik, janë kthyer në gjendjen e mëparshme në emër të P.SH. Lidhja e Luftëtarëve të L.N.Q – Kaçanik, me vet faktin se i pandehuri L.B paska bere pagesën e një urdhër pagese ndaj një Aktvendimi te Gjykatës se Apelit, qe ka pas lidhshmëri me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe sipas konstatimit të PSRK-së e ka ditur se ekziston një Aktgjykim i Gjykatës Supreme dhe se e paska ditur se çfarë qenka vendosur në të, gjykata thekson se një konkludim si i tille është plotësisht i paqëndrueshëm, pas që në shkresat e lëndës nuk ka prova që i pandehuri L.B e ka pranuar Aktgjykimin e lartcekur, me pas nuk e vërteton faktin se i njëjti ka mundur ta dijë epilogun e një vendimi që nuk ishte marrë ende pasi që një pagesë për një Urdhër pagesë ndaj një aktvendimi të Gjykatës së Apelit shkallës së dytë vetëm i paraprinë procedurave për dërgimin e lëndës në gjykatën e shkallës së tretë përkatësisht Gjykatës Supreme dhe në kohën e kryerjes së pagesës lënda ende nuk ishte dërguar në Gjykatën Supreme lere më të merret vendim, për të i pandehuri L.B të ishte në dijeni se epilogun e këtij vendimi. Vet i pandehuri L.B e ka pohuar se një pagese te tille e ka realizuar, dhe atë me kërkesën e te autorizuarit te familjes- avokatit, por ne asnjë mënyrë kjo nuk mund te vërtetoj faktin qenësor se i pandehuri L.B ishte ne dijeni se çfarë përmbante ankesa e hartuar nga avokati i angazhuar nga familjaret, veprimi i te pandehurit L.B ishte thjeshte një veprim administrativ dhe asgjë me shume. Gjithashtu gjykata potencon faktin se i njëjti nuk ishte pale në këtë procedure civile, se ne cilësinë e palës paditëse ne këtë kontest ishin familjaret e tij përkatësisht baba dhe axhallarët.

Pretendimi i PSRK-së se i pandehuri L.B e ka mashtruar të dëmtuarin A.B duke e bindur për të investuar duke nënshkruar kontratat si përfaqësues i familjes Berisha është në kundërshtim me provat e çështjes, ngase i dëmtuari A.B ka arritur marrëveshje me R.B, E.B, H.B dhe K.B të cilët janë pronarë të kësaj parcele dhe së bashku me ta kanë shkuar pranë noterit Hebib V. Livorcka ku kanë arritur marrëveshje me shkrim dhe kanë nënshkruar kontratat të përpiluara nga noteri. Po ashtu nuk qëndron fakti se i pandehur L.B ka qene prezent te noter kur edhe janë nënshkruar kontrata mes palëve kontraktuese ashta siç pretendon prokuroria, se nuk ka qene prezent ketë e vërteton edhe i dëmtuari A.B në deklaratën e tije dhënë në prokurori me datë 01.10.2022, kur prokurori dëshmitarit A.B i parashtron pyetjen se a i kujtohet, a ka qene i pranishëm tek noteri duke aluduar ne te pandehurin L.B, i dëmtuari A.B ka thënë se nuk e di e nuk i kujtohet që i pandehuri L.B të ketë qenë prezent.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk del pretendimi i prokurorisë që i pandehuri L.B e ka mashtruar të dëmtuarin A.B dhe ka përfituar nga ai pasi që nga provat të cilat janë bashkangjitur aktakuzës del se i pandehuri L.B nuk i ka përfituar banesat ashtu siç pretendon prokuroria në aktakuzës, pasi që në bazë të kontratave të lidhura tek noteri del se i pandehuri L.B e ka përfituar vetëm një banesë dhe atë nga trashëgimia, por jo të gjitha banesat dhe lokalet tjera që i potencon prokuroria se përfitues është i pandehuri L.B, pasi që banesat dhe lokalet tjera janë në regjistruara në emër të personave tjerë si: një (1) lokal afaristë në katin përdhese, me sipërfaqe 80 metra katror, me nr.3, në bazë të tatimit në pronë sipërfaqe prej 72 metra katror, janë të regjistruara në emër të investitorit A.B, e regjistruar në bazë të parcelës katastrale me nr..... me sipërfaqe prej 0.28.17 ha (2817m2) ZK – Kaçanik, një (1) banesë në katin e I-rë, nr.1, me sipërfaqe 101.08 metra katror, sipas regjistrimit të tatimit në pronë dhe para kontratës e lidhur me datë20.10.2019, me investitorin A.B, e regjistruar në bazë të parcelës katastrale me nr..... me sipërfaqe prej 0.28.17 ha (2817m2) ZK – Kaçanik, kjo banesë është regjistruar në emër të B.B (vëllai i A.Bt), një (1) banesë në katin e II-të, nr. 2, me sipërfaqe 101.08 metra katror, sipas regjistrimit të tatimit në pronë dhe para kontratës e lidhur me datë20.10.2019, me investitorin A.B, e regjistruar në bazë të parcelës katastrale me nr.....me sipërfaqe prej 0.28.17 ha (2817m2) ZK – Kaçanik, kjo banesë është regjistruar në emër të I.M, një (1) lokal afarist në katin përdhese nr.1, me sipërfaqe 84 metra katror, e regjistruar në bazë të parcelës katastrale me nr.....me sipërfaqe prej 0.28.17 ha (2817m2) ZK – Kaçanik, sipas tatimit në pronë, është në emër të E.B, 3 (tri) locale me nga 28 metra katror (gjithsejtë 84 metra katror), një (1) banesë në katin e I-rë, nr.3, me sipërfaqe 101.72 metra katror, e regjistruar në bazë të parcelës katastrale me nr.....me sipërfaqe prej 0.28.17 ha (2817m2) ZK – Kaçanik, sipas tatimit në pronë, kjo banesë është regjistruar në emër të N.B, një (1) banesë në katin e II-të, nr.6, me sipërfaqe 101.72 metra katror, e regjistruar në bazë të parcelës katastrale me nr.....me sipërfaqe prej 0.28.17 ha (2817m2) ZK – Kaçanik, sipas tatimit në pronë, kjo banesë është e regjistruar në emër të F.B, një (1) banesë në katin e III-të, nr.9, me sipërfaqe 101.72 metra katror, e regjistruar në bazë të parcelës katastrale me nr.....me sipërfaqe prej 0.28.17 ha (2817m2) ZK – Kaçanik, sipas tatimit në pronë kjo banesë është e regjistruar në emër të H.B.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ka prova të propozuar në aktakuzë që vërtetohet se Komuna e Kaçanikut ka pranuar Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.254/2009

të datë 16.01.2012, ku më pas Komuna e Kaçanik si organ i pushtetit lokal ka pas detyrim ligjor që ta zbatoj Aktgjykimin e lartcekur, si pasoje e kësaj R.B, E.B, H.B dhe K.B pranë kësaj komune kishin nxjerre fletët poseduese - certifikatën e pronës ne emër të tyre, me pas investitori A.B se bashku me pronaret e tokave ishim pajisur me terë dokumentacionin e nevojshëm dhe të domosdoshëm për ndërtimin e objektit shume banesore, pa as një pengës ligjore.

Andaj gjykata me asnjë provë nuk ka mundur të konstatoj se i pandehuri L.B me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm ka arritur ta mashtrrojë tani të dëmtuarin A.B pasi që edhe vet i njëjti në deklaratimet e tij në prokurori ka theksuar se ndihet i mashtruar nga Komuna e Kaçanikut dhe familja në tersi, jo nga i pandehuri L.B në veçanti.

Sipas vlerësimit të gjykatës, jo çdo dyshim është i mjaftueshëm për të ngritur aktakuzë nga ana e Prokurorit të Shtetit, por duhet të ekzistoi një shkallë tejet e lartë e dyshimit, përkatësisht duhet të ekzistojë dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri L.B ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet. Një gjë e tillë është parashikuar në disa dispozita ligjore por vlen të përmendet neni 234 i KPP-së. Në nenin 234 par.1 të KPP-së është parashikuar se *“për tu ngritur aktakuzë duhet të ekzistojë një dyshim i bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale”*. Pra për tu ngritur aktakuza duhet që të ekzistojë *“dyshimi i bazuar mirë”* dhe është detyrim i Prokurorit të Shtetit, që gjykatës t’ia argumentoi se ekziston një dyshim i tillë gjë që në këtë çështje penale nuk është vepruar në këtë mënyrë. Prandaj, në mungesë të provave dhe arsyeve të lartcekura, gjykata ka ardhur në përfundim se ndaj të pandehurit L.B nga Kaçaniku, nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë të ketë kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe në mbështetje të nenit 244, par. 1, pika 1.5 KPP-së, gjykata me këtë aktvendim hodhi poshtë aktakuzën dhe pushoi procedurën penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komfor neni 453, par.1 të KPPK-së.

Vendimin mbi kërkesën pasurore juridike, gjykata e mori komfor nenit 462, par.2 të KPPK-së.

Vendimi për kthimin e pasurisë së ndaluar me urdhër ndalues përfundimtar është marrë konform nenit 265 paragrafi 4 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 248, par. 1, pika 1.5 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti Special
PS.nr.53/22 datë 30.05.2023

Bashkëpunëtori Profesional
Laurant Avdyli

Kryetarja e trupit gjykues
Violeta Namani Hajra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesë në gjykatën e Apelit të Kosovës, brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.